

V E N D I M
P Ë R
NJË SHITESË FONDI, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHITETIT PËR SISTEMIN
E DREJTËSISË, MIRATUAR PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në zërin “Shpenzime personeli”, i shtohet fondi, prej 9 929 904 (nëntë milionë e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të personelit mbështetës të caktuar pranë tij nga Gjykata e Lartë.
 2. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në zërin “Shpenzime operative”, i shtohet fondi, prej 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekësh, për shpërblimin e ekspertëve dhe shpenzimet e tjera operative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
 3. Efekti financiar, prej 13 229 904 (trembëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019.
 4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 janar 2019.
 5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I
E D I R A M A

****SHËNIM: BAZUAR NË NENIN 117 TË KUSHTETUTËS SË RSH DHE NENIT 29 TË LIGJIT PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PUBLIKOHEN NË FLETORIN ZYRTARE DHE HYJNË NË FUQI PAS BOTIMIT TË TYRE. DREJTORIA E KOMUNIKIMIT PRANË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËRPIQET TË BOTOJË NË KOHËN MË TË SHPEJTË TË MUNDSHME VENDIMET E MBLEDHJEVE TË QEVERISË, POR VERSIONI ZYRTAR DHE HYRJA E TYRE NË FUQI BËHET VETËM PASI VENDIMI BOTOHET NE QBZ. SHPESHHERË, VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE KANË NEVOJË PËR ZBARDHJE TË MËTEJSHME, ÇKA E VONON PUBLIKIMIN E TYRE NË KËTË FAQE.***